



AS NË PËRPPJEKJEN E GJASHTË NUK ËSHTË KONSTITUUAR KUVENDI I KOSOVËS

BLLOKADA VAZHDON, VETËVENDOSJA SËRISH 57 VOTA



Deputetët kanë dështuar ta konstitujnë Kuvendin e Kosovës të premten në përpjekjen e gjashtë, pasi kandidatja e Lëvizjes

Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk i ka marrë votat e nevojshme. Haxhiu i ka marrë 57 vota për, katër më pak se minimumi prej 61

votave të nevojshme për t'u emëruar kryetare. Haxhiu nuk është votuar për kryetare në katër seanca radhazi

**OSMANI
UA KËRKON
PARTIVE POLITIKE
EMRAT PËR
ANËTARË TË
RINJ TË KOZ-së**

F. 3



**DEFICIT TREGTAR
PREJ 21,8 % NË
MUAJIN MARS
KRAHASUAR ME
MARSIN E VITIT
TË KALUAR**

F. 8



**ATK-ja DHE ASK-ja
NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI**

F. 6

**KEK-U THOTË SE KA PËRFUNDUAR
ME SUKSES REMONTI I NJËSISË B1**

F. 8

SPORT



**SONTE GJYSMËFINALJA E TRETË NË
MES TË TREPÇËS DHE PRISHTINËS**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mexhiti takon Aggelerin: ShBA-ja mbështet luftën kundër korrupsionit dhe integrimin në BE

SHKUP, 25 PRILL - Lufta kundër korrupsionit dhe përparimi drejt integrimit evropian ishin në qendër të takimit të zhvilluar sot në mes të zëvendëskryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, dhe ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Angela Aggeler. “Lufta kundër korrupsionit dhe përparimi drejt integrimit evropian nuk kanë alternativë. Ky ishte mesazhi që përcolla sot në një takim të rëndësishëm me ambasadoren e ShBA-së në

Maqedoninë e Veriut, znj. Angela Aggeler, një aleate dhe mike e madhe e vendit tonë”. “Diskutuam gjerësisht për thellimin e partneritetit strategjik mes vendeve tona, mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për reformat në drejtësi dhe përpjekjet tona të palëkundura në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. E ritheksova përkushtimin e Qeverisë për procesin eurointegruar dhe për rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë në kuadër të NATO-s, si garanci për siguri,



stabilitet dhe zhvillim”, ka shkruar në “Facebook” Mexhiti. Ai ka treguar se kanë biseduar edhe për projektet madhore infrastrukturore, përfshirë ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10d, që janë thelbësore për rritjen ekonomike dhe lidhjen e qëndrueshme rajonale. “Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore e konstruktive, duke rikonfirmuar vullnetin tonë të përbashkët për një bashkëpunim të thelluar dhe afatgjatë me Shtetet e Bashkuara”, ka shkruar Mexhiti.

Ministri francez: BE-ja dhe ShBA-ja, larg arritjes së marrëveshjes për tarifrat



PARIS, 25 PRILL - Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara ende janë larg që të arrijnë një marrëveshje për tarifrat, tha ministri francez i Ekonomisë, Eric Lombard, teksa blloku po synon të gjejë një shtegdalje nga tensionet tregtare me Uashingtonin. Presidenti amerikan Donald Trump ka vendosur tarifa prej 10-përqindësh ndaj shumicës së partnerëve tregtarë dhe ka vendosur tarifa më të larta ndaj importeve të çelikut, aluminit dhe

industrisë së automobilave. BE-ja nuk është kursyer nga tarifrat, por tarifrat më të larta të vendosura ndaj mallrave të bllokut janë pezulluar për 90 ditë. Por, ky pezullim do të skadojë në fillim të korrikut. “Ne nuk do ta fshehim faktin që ende ka shumë rrugë deri tek arritja e një marrëveshjeje”, tha ministri francez i Ekonomisë, Eric Lombard, gjatë një prononcimi për gazetarë në margjinat e takimeve në Uashington të Fondit

Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore. Megjithatë, ai tha se bisedimet me zyrtarët amerikanë ishin të mira. Ai tha se gjatë kësaj jave është takuar me drejtorin e Këshillit Kombëtar Ekonomik të Shtëpisë së Bardhë, Kevin Hassett, sekretarin amerikan të Tregtisë, Howard Lutnick, dhe atë të Thesarit, Scott Bessent. Lombard theksoi se homologët e tij kanë dëshirë “që të lëvizet përpara sa më shpejt që të jetë e

mundur”, duke shtuar se evropianët janë përkrahur si miq dhe aleatë, në kontekstin e këtyre bisedimeve. Por, Lombard tha se pret “ulje dhe ngritje” në negociatat e palëve. Trump fillimisht ka vendosur tarifa ndaj importeve të çelikut dhe aluminit të BE-së. Më pas, blloku evropian ishte pjesë e tarifave reciproke të Trumpit, me 20 për qind tarifa. Këto tarifa reciproke goditën shumicën e partnerëve tregtarë të Uashingtonit.

E vizitoi më shumë se 100 herë, ja pse Papa Françesku zgjodhi të prehej në Santa Maria Maggiore

VATIKAN, 25 PRILL - Papa Françesku, figura e dashur dhe me ndikim e Kishës Katolike, do ta bëjë udhëtimin e tij të fundit në bazilikën Santa Maria Maggiore, një nga katër bazilikat papale në Romë, të cilën e ka vizituar shpesh gjatë papatit të tij 12-vjeçar. Pas një jete të përkushtuar ndaj thjeshtësisë dhe paqes, Françesku, që ndërroi jetë në moshën 88 vjeçare, do të varroset në këtë bazilikë historike, një vend që ka pasur një lidhje të veçantë për të. Santa Maria Maggiore, një bazilikë e ndërtuar në shekullin e katërt, ndodhet në një nga shtatë kodrat

e lashta të Romës, në lagjen Esquilino, e cila është tani një nga zonat më të jetuara dhe multikulturore të qytetit. Françesku, që ka vizituar këtë kishë për më shumë se 100 herë, ka gjetur këtu qetësinë shpirtërore dhe një lidhje të veçantë me Marinë, nënën e Perëndisë. Në një moment të paharrueshëm ai përjetoi një përballje të ngushtë me një hajdut xhepi, një ngjarje që e mbajti mend gjithë jetën. Megjithatë, kjo nuk i ka cenuar vizitat e tij në Santa Maria Maggiore, një vend i shenjtë ku ai ndihmoi të varfrit dhe mbante gjithmonë një qëndrim të thjeshtë



dhe të përulur. Në një vendim të jashtëzakonshëm dhe të papritur për papën, Françesku e ka zgjedhur këtë bazilikë si vendin e tij të varrimit. Pas vdekjes, arkivoli i tij i thjeshtë do të shërbejë si simbol i përkushtimit të tij ndaj

jetës të thjeshtë dhe të pandikuar nga lukset. Ai do të varroset në një kamare të vogël në majtë të bazilikës, një vend që ai e kishte zgjedhur vetë pas një vizite të veçantë në prill të vitit 2023. Bazilika, që është gjithashtu vend i varrit të skulptorit të njohur Gian

Lorenzo Bernini, ka pasur një rritje të vizitorëve dhe pelegrinëve vitet e fundit, veçanërisht pas vdekjes së papës. Me mozaikët e saj të mrekullueshëm dhe kishën e projektuar nga Michelangelo, Santa Maria Maggiore ofron një vend për meditim dhe lutjen, duke shndërruar çdo vizitë në një përvojë shpirtërore të paharrueshme. Për të gjithë ata që kërkojnë të përjetojnë paqen që Françesku shpërndau gjatë jetës së tij, Santa Maria Maggiore mbetet një vend që ka një rëndësi të thellë dhe do të vazhdojë të tërheqë pelegrinë dhe vizitorë nga e gjithë bota.

Witkoffi dhe Putini diskutojnë për njohjen e Krimesë

I dërguari kryesor i Shtëpisë së Bardhë për Rusinë u takua me presidentin rus Vladimir Putin, me një propozim për paqe që do të përbënte një kthesë të madhe në politikën amerikane: njohjen e pretendimit të Moskës për Krimenë, territor i Ukrainës. Propozimi, i cili fillimisht ka

qarkulluar nga zyrtarë amerikanë pas bisedimeve në Paris javën e kaluar, është një nga disa temat që Steve Witkoff pritet të ngrejë në takimin me Putinin më 25 prill. Teksa lufta e Rusisë kundër Ukrainës tashmë ka hyrë në vitin e katërt, ky plan

përfaqëson një përpjekje të madhe të Uashingtonit për ta zhbllokuar ngërçin diplomatik dhe për ta ndalur luftën më të madhe tokësore në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ky është, gjithashtu, një ndryshim i thellë në politikën amerikane, sidomos sa i përket statusit të Krimesë, të

cilën Moska e pushtoi dhe më pas e aneksoi në vitin 2014. Përveç një numri shumë të vogël shtetesh, aneksimi nuk është njohur ndërkombëtarisht. Që nga ajo kohë - përfshirë edhe gjatë administratës së parë të Trumpit - politika amerikane ka refuzuar pretendimin rus.



Osmani ua kërkon partive politike emrat për anëtarë të rinj të KQZ-së

Prishtinë, 25 prill - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka kërkuar partive politike t'i propozojnë emrat për anëtarë të rinj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).


Bekim Kupina, këshilltar i presidentes, ka konfirmuar se Osmani tashmë ua ka dërguar një shkresë grupeve parlamentare që janë regjistruar në Kuvendin e Kosovës.

Ndërkaq Ligji për Zgjedhjet e obligon presidenten që jo më vonë se 30 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve parlamentare t'ua kërkojë grupeve parlamentare propozimet për anëtarë të KQZ-së. "Presidenti i Republikës së Kosovës, bazuar në rezultatet që kanë dalë nga zgjedhjet e përgjithshme, jo më vonë se 30 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve për Kuvend, u kërkon grupeve parlamentare/subjekteve politike të propozojnë me shkrim kandidatët për anëtar të KQZ", thuhet në paragrafin 6 - neni 61.

Në këtë nen thuhet se "grupet parlamentare/subjektet politike brenda afatit prej 7 ditësh i dërgojnë propozimet e tyre dhe emërimi nga presidenti bëhet brenda 5 ditësh nga dërgimi i propozimeve".

Mandati i anëtarëve të KQZ-së është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim fillon jo më vonë se 60 ditë pas certifikimit të rezultateve. Fillimi i mandatit nënkupton përfundimin e mandatit paraprak.

KQZ-ja ka certifikuar më 27 mars rezultatet e zgjedhjeve të 9 shkurtit.



mars rezultatet e zgjedhjeve të 9 shkurtit.

PAL LEKAJ PROPOZON FORMIMIN E NJË QEVERIE KALIMTARE ME MANDAT 6-8 MUJOR

PRISHTINË, 25 PRILL - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Pal Lekaj, ka reaguar ndaj situatës së fundit politike në vend. Ai ka thënë se situata politike e krijuar pas zgjedhjeve të fundit paraqitet e ndërlikuar dhe me potencial për të prodhuar vetëm zgjidhje afatshkurtra. "Në mënyrë që të mos i lodhim qytetarët tanë me përplasje dhe bllokada politike që burojnë nga mospajtimet ndërpartiake, propozoj një zgjidhje të përbashkët dhe gjithëpërfshirëse: Formimin e një qeverie kalimtare me mandat 6-8 mujour, e cila do të kishte për detyrë ta menaxhonte vendin deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme të cilat do të organizoheshin në fund të muajit nëntor ose në fillim të dhjetorit. Kjo datë do të përkonte me përfundimin e mandateve të kryetarëve të komunave, si dhe do të ishte



një hap drejt afrimit të zgjedhjeve për presidentin e vendit", ka shkruar Lekaj në "Facebook".

Zyrtari i lartë i AAK-së ka thënë se kjo do të ishte një mundësi ideale për organizimin e një "pakete

zgjedhore 3-në-1", ku qytetarët me një dalje në votime do të zgjidhnin: 1. Përbërjen e re të Kuvendit

dhe qeverinë e ardhshme, 2. Presidentin e ri të vendit, 3. Kryetarët e komunave. "Një qasje e tillë do të sillte përfitime të shumta: Reduktim të kostove buxhetore, kursim kohe për qytetarët dhe institucionet, dhe rritje të besueshmërisë dhe legjitimitetit të institucioneve. Ky është një propozim që kërkon maturi politike, përgjegjësi dhe vullnet për zgjidhje, e jo për thellim të krizës", ka thënë Lekaj.

Ai ka dhënë edhe një zgjidhje të mundshme për kryetarin e Kuvendit. "Le ta propozojë Lëvizja Vetëvendosje cilindo nga deputetët e pakicave jo-serbe për këtë pozitë. Le të tregojmë tolerancë dhe besim ndaj atyre që kanë dëshmuar besnikëri dhe përgjegjësi ndaj Republikës sonë. Kjo është një mundësi për të forcuar bashkëjetesën, përfaqësimin dhe unitetin institucional", ka deklaruar Lekaj.

KURTI PRET NË TAKIM DREJTUES DHE PËRFAQËSUES TË ODËS EKONOMIKE TË BOSNJËS, FLASIN PËR KRIJIMIN E PARTNERITETEVE PËR INVESTIME



Prishtinë, 25 prill - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministren e tretë për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut, Emilija Rexhepi dhe shefin e stafit, Luan Dalipi, ka pritur të premtën në takim drejtues dhe përfaqësues të Odës Ekonomike të Bosnjë-Hercegovinës.

Në fillim të bashkëbisedimit, kryeministri theksoi se takimi i sotëm simbolizon angazhimin për ta rritur bashkëpunimin

tonë dhe për ta nxitur prosperitetin e ndërsjellë.

Kryeministri Kurti vlerësoi rolin që mund të luajnë komunitetet e biznesit të të dyja vendeve, të cilat kanë potencial për t'i rritur shkëmbimet tregtare dhe për të krijuar partneritete për investime, nga të cilat do të përfitojnë bashkërisht edhe Kosova edhe Bosnjë-Hercegovina. Ai shtoi se duke rritur flukset tregtare e shkurtuar barrierat logjistike,

krijojmë një mjedis biznesi bashkëpunues dhe në të mirë të dy vendeve.

Kryeministri Kurti tha se vendimi për t'i lejuar në mënyrë të njëanshme qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës të hyjnë në territorin e Kosovës duke përdorur vetëm letërnjoftimet biometrike, në fuqi nga 1 janari 2025, shërben si shtysë dhe ndikim pozitiv në lëvizjen e lirë dhe marrëdhëniet mes dy vendeve.

Komuna e Prishtinës s'i ndalon ekskursionet për maturantët

PRISHTINË, 25 PRILL - Nënkryetari i komunës së Prishtinës, Shkëmb Manaj, pas raportimeve në medie, ka bërë me dije se nuk do të ndalohen ekskursionet dhe mbrëmjet e maturës.

"Për shkak të sqarimit të opinionit publik, ju njoftojmë që nuk do të ndalohen ekskursionet dhe mbrëmjet e maturës në kryeqytet. Drejtoria e Arsimit në kryeqytet, së bashku me Zyrën Ligjore, është duke finalizuar aktin udhëzues i cili rregullon aktivitetet ekstrakurrikulare si mbrëmjet e maturës, semimaturës, ekskursionet brenda dhe jashtë Prishtinës, ditët e shkollave e të tjera, i cili vlen për procedurat në të ardhmen", ka shkruar Manaj në "Facebook".





AS NË PËRPPJEKJEN E GJASHTË NUK ËSHTË KONSTITUUAR KUVENDI I KOSOVËS

BLLOKADA VAZHDON, VETËVENDOSJA SËRISH 57 VOTA

Deputetët kanë dështuar ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës të premten në përpjekjen e gjashtë, pasi kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk i ka marrë votat e nevojshme. Haxhiu i ka marrë 57 vota për, katër më pak se minimumi prej 61 votave të nevojshme për t'u emëruar kryetare. Haxhiu nuk është votuar për kryetare në katër seanca radhazi

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 PRILL - Deputetët kanë dështuar për herë të gjashtë radhazi në përpjekjen për ta konstituuar Kuvendin. Procesi ka ngecur pasi partia fituese, Lëvizja Vetëvendosje, nuk po arrin t'i sigurojë votat e nevojshme për kandidaten për kryetare të Kuvendit. Albulena Haxhiu dhe në herën e katërt i mori vetëm 57 vota, nga të paktën 61 vota të nevojshme për t'u zgjidhur. Haxhiu nga disa parti parlamentare shihet si “figurë përçarëse”, por Vetëvendosja ngul këmbë se ajo është kandidate meritore. Vazhdimi i seancës konstituive do të mbahet më 27 prill në orën 10:00.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka thënë se partia e tij nuk do të heqë dorë nga kandidatura e Albulena Haxhiut për kryetare të Kuvendit pavarësisht prej mungesës së votave dhe kundërshtimeve. “Kuvendit kemi dashur t’ia japim një kryetare grua. Ky është

propozimi ynë që nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë”, tha ai. Ai tha se kundërshtimet ndaj kandidaturës së Haxhiut “janë më shumë taktika sesa ndonjë arsye konkrete”. Murati u ka bërë thirrje partive të tjera parlamentare të “reflekojnë”.

Ndërkaq e propozuara e LV-së për pozitën e kryeparlamentares, Albulena Haxhiu, ka thënë se nëse Kuvendi i Kosovës nuk arrin të konstituohet, siç po ndodh që gjashtë herë, “atëherë është e qartë që vendi duhet të shkojë në zgjedhje”. “Duket që ka mungesë të vullnetit që të konstituohet Kuvendi i Kosovës, por ne jemi shumë të gatshëm t'i presim partitë politike që të flasim me to për datën e zgjedhjeve”, tha Haxhiu.

E pyetur nëse do të tërhiqej nga kandidatura për pozitën e kryeparlamentares pas dështimit për të katërtën herë, ajo tha se “Vetëvendosja e ka qëndrimin e qartë”. Përfaqësuesit e LV-së kanë

insistuar në kandidaturën e Haxhiut, duke thënë se nuk u takon partive të tjera ta përcaktojnë propozimin e LV-së.

Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje qëllimshëm nuk dëshiron ta zhblllojë konstituimin e Kuvendit të Kosovës pasi nuk po ndryshon propozimin për pozitën e kryeparlamentarit. “Një gjë është e qartë, Albulena Haxhiu nuk kalon. Sikur të donin zgjidhje, kanë pasur mundësi edhe sot, edhe pardje, edhe para katër ditësh. Të njëjtën mundësi e kanë edhe pasnesër: Ta ndërrojnë deputetin”, tha Krasniqi, i cili shprehu bindjen se kështu po ndodh për shkak se LV-ja nuk i ka votat e mjaftueshme për ta formuar qeverinë. “Kjo tashmë është komplet e pakuptimtë, e turpshme, që për teket e një personi, një kandidati, të mbahet peng shteti”, tha Krasniqi. Ai tha se nëse Kuvendi nuk konstituohet, zgjidhja do të ishte të mbahen

zgjedhje të jashtëzakonshme në maj të këtij viti.

Krasniqi shtoi se, përveç Haxhiut, ka edhe emra të tjera nga LV-ja që PDK-ja nuk do t'i votonte për pozitën e kryeparlamentarit, por nuk foli për ta.

Deputeti dhe kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, i ka bërë thirrje partisë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje, t’ua hapë rrugën partive të tjera parlamentare për formimin e institucioneve të reja. “Besoj se tashmë është bërë e qartë se partia që i ka fituar zgjedhjet nuk i ka votat dhe është koha të lëshojë rrugë për të krijuar një shumicë e cila do t'i themelonte institucionet”, tha Limaj për gazetarë.

Ai tregoi se partia e tij nuk ka marrëveshje politike me asnjë parti.

Kryetarja e Unionit Socialdemokrat nga radhët e komunitetit boshnjak, Duda Bale, tha se ajo nuk do ta votojë kandidaten e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, për kryetare të Kuvendit. “Unë i qëndroj qëndrimit të partisë sime. Nuk e ndryshojmë qëndrimin”, tha ajo.

Albert Krasniqi nga Demokraci Plus (D+) në Prishtinë ka theksuar për “Radion Evropa e Lirë” se në aspektin politik, konstituimi i Kuvendit gjendet në një bllokadë për shkak të

Lëvizjes Vetëvendosje, e cila nuk ka rritur t'i sigurojë 61 votat e domosdoshme nga deputetët për ta miratuar propozimin e saj. “Kur nuk i ke numrat, duket kompromis dhe nuk mund të imponosh kandidatë [për kryetar të Kuvendit]”, thekson Krasniqi. Ai shton se, marrë parasysh refuzimin kategorik të propozimit të LV-së nga tri partitë e tjera, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, partia fituese do të duhej të lëshonte pe.

“Do të duhej që Lëvizja Vetëvendosje të bënte përpjekje për të dialoguar me partitë politike, në mënyrë që të ketë një kandidat të përshtatshëm - së paku për shumicën e deputetëve - në mënyrë që ta zhblllojë situatën”, thotë Krasniqi.

Mendim të njëjtë ka shprehur edhe profesori i të Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu. Ai thekson se partitë politike duhet ta gjejnë një kompromis, i cili do ta zhblllokonte ngërçin në të cilin ka ngecur konstituimi i Kuvendit. Kompromisi, sipas tij, nënkupton një marrëveshje që përfshin propozimet në pako për kryetarin e Kuvendit dhe për pesë nënkryetarët nga partitë shqiptare dhe të komuniteteve pakicë joserbe dhe serbe.

Mungesa e marrëveshjes eventuale ndërmjet partive

THAÇI DEKLAROHET I PAFAJSHËM PËR FORMËN E RE TË PËRGJEGJËSISË QË IU SHTUA NË RASTIN KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË

PRISHTINË, 25 PRILL - Hashim Thaçi ka deklaruar se është i pafajshëm për formën e re të përgjegjësisë për 'nxitje', e cila iu shtua pas një vendimi të Apelit në rastin e tij kundër administratës së drejtësisë. Në këtë rast ai është i akuzuar së bashku me Bashkim Smakajn, Fadil Fazliun, Isni Kilajn dhe Hajredin Kuçin.

Deklaratën Thaçi e ka dorëzuar me shkrim përmes mbrojtjes më 24 prill 2025. "Në përputhje me Rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, deklarata me shkrim e z. Thaçi për mospranim të fajësisë për secilën pikë dhe akuzë në Aktakuzën e Rikonfirmuar të ndryshuar, përfshirë edhe formën shtesë të nxitjes për Pikat 1 deri në 3, është e bashkangjitur me këto parashtresa", thuhet në njoftimin e mbrojtjes së Thaçit, raporton "Betimi për Drejtësi".

Më 14 prill 2025 gjyqtarja e procedurës paraprake, Marjorie Masselot, ka ndryshuar vendimin e vet të mëparshëm për konfirmimin e aktakuzës, duke konfirmuar formën e përgjegjësisë penale për Thaçin që bie në bazë të nenit 32 (3) të KPRK-së që ka të bëjë për shtytje në kryerjen e veprës penale të "Pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", në bazë të nenit 401 (3) dhe (5) të KPK-së.

Gjykata e Apelit e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë ka aprovuar pjesërisht ankesën e Prokurorisë ndaj vendimit për konfirmimin e aktakuzës në rastin ndaj Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilat, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, ku është shtuar një formë e përgjegjësisë penale ndaj Thaçit në rastin kundër administrimit të drejtësisë..

Nga katër pika të ankesës së ZPS-së u pranua vetëm ajo që kishte të bënte me përgjegjësinë e Thaçit për nxitjen e Kilajt, Smakajt dhe Fazliut për ta kryer veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Paneli i Apelit ka marrë vendim që një nga katër pikat që kishte ngritur ZPS-ja kundër vendimit për konfirmimin e aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, ta pranojë lidhur me përgjegjësinë penale të Thaçit për 'nxitje' në kryerjen e veprës penale "Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare".

Pika e katërt e ankesës së ZPS-së kishte të bënte me kundërshtimin e konstatimit të gjyqtarës që neni 32 (3) i KPRK-së nuk zbatohet për veprën "Pengim i personave zyrtarë" sipas nenit 401 (3) dhe (5) të KPRK-së.

Sipas ZPS-së, gjyqtarja ka gabuar kur ka konstatuar se për shkak se neni 401 (3) dhe (5) të KPRK-së nuk parashikon dënim deri në pesë vjet burgim, për rrjedhojë neni 32 (1) nuk është i zbatueshëm pasi, sipas saj, kjo dispozitë zbatohet vetëm për vepra që janë të dënueshme më pak se pesë vjet.

Sipas ZPS-së, gjykatësi i procedurës paraprake ka gabuar duke konstatuar se, për shkak se neni 401 (3) dhe (5) i KPK-së parashikon dënim nga një deri në pesë vjet burgim, neni 32 (3) nuk ishte i zbatueshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet vetëm për vepra të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim. Mbrojtja e Thaçit kishte thënë se gjyqtarja e ka interpretuar saktë këtë nen.

Neni 32 (3) i KPRK-së për



"Shtytje" thotë se "Kushdo që me dashje shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe vepra penale as që është tentuar, shtytësi dënohet për tentativë".

Sipas Panelit, gjyqtarja kishte konstatuar se vepra që bie në nenin 401 (3) të KPRK-së është e dënueshme nga 1 deri në 5 vjet burgim, prandaj e përjashtoi përgjegjësinë e Thaçit sipas nenit 32 (3) të KPRK-së për pikën 1, 4 dhe 4 të aktakuzës. Veç kësaj, paneli kishte thënë se ka mospajtime për interpretimin e këtij neni pasi, sipas tij, panele më të ulëta kanë interpretuar që ky nen është i zbatueshëm për veprat penale të dënueshme mbi pesë vjet dhe disa për ato të dënueshme nën 5 vjet.

Në vendim thuhet se me shumicë votash Paneli ka rënë dakord me ZPS-në, duke thënë se neni 32 (3) duhet të zbatohet për vepra që përfshijnë ose edhe i tejkalojnë pesë vjet burgim. "Si rezultat, Paneli konstaton, me shumicë votash, se duke qenë se vepra e pengimit të personave zyrtarë është e dënueshme në format e

saj të rënduara me burgim nga një (1) deri në pesë (5) vjet, forma e tretë e nxitjes sipas nenit 32(3) të KPK-së është e zbatueshme në këtë rast", thuhet në vendim.

Si rrjedhojë, ata e konsideruan gabim konstatimin e gjyqtarës se ky nen nuk ishte i zbatueshëm për veprën "Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", kështu që Paneli pranoi pikën katër të ankesës së ZPS-së. "Duke qenë se konstatimi për ekzistencën e një dyshimi të bazuar mirë se Thaçi i ka nxitur Fazliun, Smakajn dhe Kilajn për ta kryer veprën penale të pengimit të personave zyrtarë përfshin një vlerësim faktik të provave, çështja i kthehet gjykatësit të procedurës paraprake për shqyrtim të mëtejshëm", thuhet më tutje në vendim.

Për këtë rast Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu dhe Isni Kilaj u arrestuan më 5 dhjetor 2024 në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit në DhSK, më 6 dhjetor 2024, në bazë të aktakuzës së konfirmuar dhe fletarrestimeve të lëshuara nga Haga. Ndërsa Thaçi i është

dorëzuar fletarrestimi në objektin e paraburgimit në Hagë më 5 dhjetor 2024, gjithnjë sipas njoftimit të DhSK-së. Kurse Hajredin Kuçit i është dorëzuar aktakuza e konfirmuar dhe fletëthirrja për t'u paraqitur para gjykatës së procedurës paraprake për paraqitjen e parë, e cila u mbajt më 9 dhjetor.

Sipas aktakuzës, Thaçi individualisht dhe përmes veprimeve të përbashkëta me grupet; Grupi Fazliu (Fadil Fazliu dhe Fahri Fazliu), Grupi Smakaj (Bashkim Smakaj, Blerim Shala dhe Artan Behrami) si dhe Grupi Kilaj (Isni Kilaj dhe Vllaznim Kryeziu), kanë ndjekur një model të sjelljes për t'i penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

Në aktakuzë thuhet se Thaçi ka udhëhequr dhe marrë pjesë në këto përpjekje përmes vizitave të tij në objektet e paraburgimit gjatë kohës sa ishte i paraburgosur në kuadër të gjykimit të tij për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Aty thuhet se anëtarët e Grupit Fazliu, Grupit Smakaj dhe Grupit Kilaj u koordinuan për të ndikuar në dëshmitarët e ZPS-së gjatë vizitave jo të privileguara të datave 2 korrik, 9 shtator dhe 6 tetor 2023.

Si rrjedhojë, ndaj Thaçit rëndojnë tri akuza për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, tri për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe katër akuza për mosbindje ndaj gjykatës.

Ndërsa Kilaj, Smakaj dhe Fazliu akuzohen për tentativë të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe mosbindje ndaj gjykatës, kurse Kuçi i ka dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës.

politike që do ta zgjidhte situatën për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit do ta thellonte edhe më tej ngërçin institucional. Kështu mendojnë edhe Krasniqi dhe Baraliu. Siç thonë ata, nuk ka ndonjë kufizim ligjor që seanca konstituive të vazhdojë çdo 48 orë pas secilës ndërprerje, "deri në pafundësi". "Nëse LV-ja nuk propozon emër, atëherë kjo mund të kontestohet në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se e drejta për të propozuar nuk nënkupton edhe të drejtën për të imponuar kandidat dhe, aq më pak, për ta bllokuar konstituimin e Kuvendit", thotë Krasniqi. Por, të drejtën për t'iu drejtuar për çështje të caktuara Gjykatës Kushtetuese e kanë vetëm presidentja e Kosovës, Avokati i Popullit dhe Kuvendi i Kosovës.

Cakolli: Pa u konstituuar Kuvendi nuk mund të shpallen zgjedhje të parakohshme

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se pa u konstituuar Kuvendi nuk mund të shpallen zgjedhje të parakohshme. Cakolli në "Facebook" ka shkruar se afati kushtetues 30-ditor është për thirrjen dhe mbajtjen e seancës konstituive, jo për përmbylljen e konstituimit. "Pa u konstituuar Kuvendi, kurdoherë, nuk mund të shpallen zgjedhje të parakohshme! Mbledhja konstituive e Kuvendit është thirrur. Seancat janë mbajtur dhe po mbahen çdo 48 orë. Deputetët kanë marrë pjesë dhe e kanë rrëzuar me vota, katër herë, një kandidaturë për



kryetare të Kuvendit. Këto janë faktet. Kuvendi nuk konstituohet me thirrje apo mbledhje, por vetëm me zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarëve. Afati kushtetues

30-ditor është për thirrjen dhe mbajtjen e seancës konstituive, jo për përmbylljen e konstituimit - dhe ky afat është konsumuar më 15 prill. Çdo interpretim tjetër është ose

keqkuptim, ose tentativë për t'i ikur dështimit politik", ka thënë Cakolli.

Ai ka shtuar se zgjedhjet e reja nuk shkaktohen automatikisht nga dështimi për ta zgjedhur kryetarin. Kushtetuta nuk njeh një rrugë të tillë të shkurtër. Nëse mungon shumica, zgjedhjet mbeten opsion politik por, absolutisht, jo pasojë kushtetuese. "Deri atëherë, pa shumicë, nuk ka kryetar, nuk ka Kuvend funksional dhe nuk ka as afat që e 'rregullon' vetvetiu problemin. Mbi të gjitha, edhe rruga drejt zgjedhjeve - nëse palët pajtohen për to - kalon përmes konstituimit të Kuvendit", ka deklaruar Cakolli.

Në IKShPK mbahet ushtrimi për Watch Mode - gjendje qetësie

PRISHTINË, 25 PRILL - Në ambientet e Qendrës Operative për Emergjencë të Shëndetit Publik në IKShPK u mbajt të premtën ushtrimi simulues për Watch Mode (gjendje qetësie), që paraqet njërin nga modulet e fazave të sistemit të menaxhimit të rreziqeve shëndetësore. Ushtrimi simulues u organizua

në bashkëpunim me Zyrën e OBSH-së në Kosovë dhe kishte për qëllim testimin dhe përfundimin e kapaciteteve institucionale, në përgjigje ndaj emergjencave shëndetësore, në periudha të qetësisë, përmes skenarëve të simuluar dhe diskutimeve ndërsektoriale. Në ushtrim, përveç profesionistëve të IKShPK-së,

morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe epidemiologë nga qendrat rajonale të shëndetit publik. Gjatë ushtrimit u prezantuan dhe diskutuan gjashtë detyra kryesore për menaxhimin e emergjencave në periudha të qetësisë. U theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinsti-

ucional në raste të emergjencave që përfshijnë rreziqe nga patogjenë biologjikë, kimikë, radiologjikë, si dhe fatkeqësi natyrore si: vërshimet, ndotja e ajrit, temperaturat ekstreme dhe zoonozat. Ky ushtrim dëshmoi edhe njëherë rëndësinë e koordinimit, planifikimit të hershëm dhe testimit të



vazhdueshëm të kapaciteteve të reagimit, për të siguruar një përgjigje të qëndrueshme ndaj emergjencave të shëndetit publik.

ATK-ja DHE ASK-ja NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PRISHTINË, 25 PRILL - Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës kanë nënshkruar të premtën marrëveshje të mirëkuptimit, me qëllim të rregullimit dhe përcaktimit të procedurave për pranimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet këtyre dy institucioneve. Kjo marrëveshje synon të mundësojë një bashkëpunim më të strukturuar dhe efikas në drejtim të përmirësimit të cilësisë së të dhënave statistikore në Republikën e Kosovës. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është që ASK-ja, si institucion zyrtar përgjegjës për

mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, të ketë qasje të rregullt dhe të sigurt në të dhënat administrative që mbledh ATK-ja. Këto të dhëna janë thelbësore për hartimin e statistikave të sakta dhe gjithëpërfshirëse, të cilat ndihmojnë në analizimin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale në vend. Të dyja palët, ATK-ja dhe ASK-ja, e konsiderojnë thelbësor krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, me qëllim të shkëmbimit të informacionit statistik, avancimit të sistemeve të menaxhimit të të dhënave, dhe përmbylljes së interesave të



përbashkëta institucionale. Marrëveshja përfshin gjithashtu aspekte që lidhen me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, në përputhje me legjislacionin në

fuqi dhe standardet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe institucionale. Marrëveshja është nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i

Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj dhe drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, të cilët ritheksuan përkushtimin e institucioneve që përfaqësojnë për të avancuar më tej bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe për të kontribuar në ndërtimin e një sistemi të fuqishëm të statistikave zyrtare në vend. Përmes këtij bashkëpunimi pritet të rritet efikasiteti për krijimin e statistikave zyrtare, të cilat janë bazë për planifikim të mirëfilltë, hartim të politikave publike dhe vlerësim të zhvillimeve në sektorë të ndryshëm të shoqërisë.

FILLON JAVA BOTËRORE E IMUNIZIMIT

PRISHTINË, 25 PRILL - Me moton “Imunizimi është i mundshëm për të gjithë”, në këtë vit shënohet Java Botërore e Imunizimit, e cila synon ta promovojë fuqinë jetëshpëtuese të imunizimit për t'i mbrojtur njerëzit e të gjitha moshave kundër sëmundjeve të parandalueshme me vaksinë. Motoja e këtij viti thekson rëndësinë e vazhdimin të vaksinimit për një të ardhme të shëndetshme dhe mbrojtje të vazhdueshme për fëmijët dhe të rinjtë. Vaksinimi është një mënyrë e thjeshtë, e sigurt dhe efektive për t'u mbrojtur kundër sëmundjeve të dëmshme, duke përfunduar sistemin imunitar të



trupit dhe duke e bërë atë më të fortë për t'u përballur me infeksionet. Nga viti 2023 Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike kanë vazhduar përpjekjet për ta zgjeruar programin e imunizimit, ku kalendari i rregullt i vaksinimit është pasuruar me tre vaksinë të reja: vaksinë kundër pneumokokut, vaksinë kundër rotavirusit dhe vaksinë kundër HPV-së. Këta hapa të rëndësishëm kanë sjellë një mbulueshmëri të lartë të vaksinimit në nivel vendi, me 89 % të fëmijëve të vaksinuar me vaksinat bazë dhe 13 169 vajza

dhe djem të vaksinuar me vaksinë kundër HPV. Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK, në bashkëpunim me institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, do të vazhdojë të punojë për ta garantuar sigurinë e shëndetit publik dhe për ta rritur mbulueshmërinë me vaksinë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Vaksinimi është një investim për shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë shoqërisë. Vaksinat janë prova se më pak sëmundje, më shumë jetë është e mundur kur e vendosim mendjen tek ajo. Në vitin 2025 le t'i tregojmë botës se “imunizimi është i mundshëm për të gjithë”.

Mbahet konferenca lidhur me projektin “Promovimi i të drejtave gjuhësore në komunën e Kamenicës”

Kamenicë, 25 prill - Organizata joqeveritare Dardanapress, në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave gjuhësore në komunën e Kamenicës”, përkrahur nga Zyra e Kryeministrit/Zyra e Komisionarit për Gjuhët, ka mbajtur konferencën për medie në përfundim të realizimit të projektit mbi të arriturat e objektivave dhe rezultatet e projektit. Në fillim të konferencës projekt-menaxheri Sherafedin Vranja i njoftoi të pranishmit për qëllimin dhe objektivat,

aktivitetet e realizuara gjatë implementimit të projektit. Si rekomandime kryesore të dala nga debati dhe trajnimeve janë: rritja e nivelit të respektimit të të drejtave gjuhësore nga institucionet komunale, vetëdijesimi i zyrtarëve të drejtorive komunale për përdorimin e dygjuhësisë, hartimi i rregullores komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve në nivel komunal, organizimi i aktiviteteve vetëdijesuese për komunitetet, vendosja e shenjave, njoftimeve dhe

tabelave njoftuese komunale në dy gjuhë, rritja e stafit të zyrtarëve për përkthim. Po në kuadër të aktiviteteve është organizuar kursi katërmujor për mësimin e gjuhës shqipe ku këtë kurs e kanë vijuar njëzet qytetarë të komuniteteve të komunës së Kamenicës. Rekomandimet e dala nga aktivitetet do t'i adresohen kryetarit të komunës, Zyrës së Komisionarit për Gjuhët, për shqyrtimin dhe realizimin e rekomandimeve. Në konferencë kanë marrë pjesë zyrtarë nga zyra për



komunikim dhe marrëdhënie me publikun, zyrtarë të drejtorive

komunale, zyrtarë nga zyra për komunitete, organizata të shoqërisë civile dhe medie.

KURTI PËR TAKIMIN PORFIRIJE - PUTIN: PARTNERITET STRATEGJIK QË E VË RAJONIN NË RREZIK SERIOZ

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se takimi në mes të kreut të Kishës Ortodokse Serbe, Porfirije, dhe presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, nuk ishte një diplomaci fetare, “por një partneritet strategjik i regjimeve autoritare që vë rajonin në rrezik serioz”.

Kurti e cilësoi takimin e zhvilluar në Kremlin më 22 prill “shqetësues” dhe tha se Kisha Ortodokse Serbe për një kohë të gjatë ka luajtur rol aktiv politik. “Patriarku [Porfirije] bëri thirrje për një rreshtim më të gjerë gjeopolitik nën udhëheqjen ruse, duke përsëritur se ‘varka e vogël serbe, duke lundruar në një det të trazuar, duhet të jetë gjithmonë e lidhur pas anijes së madhe ruse’. Ai po ashtu sugjeroi se qëndrimi i Serbisë ndaj fqinjëve të saj - Kosovës, Bosnje e Hercegovinës dhe Malit të Zi - varet nga pozita globale e Rusisë”, shkroi Kurti në X.

Kurti tha se deklarata e bërë nga Porfirije për rreshtimin gjeopolitik u bën para se presidenti serb Aleksandar Vuçiq ta vizitojë Moskën. Vuçiqi ka konfirmuar se ai do të marrë pjesë në shënimin e Ditës

së Fitores më 9 maj në Moskë, vizitë që është kritikuar nga Bashkimi Evropian.

Gjatë takimit në Kremlin, Porfirije kishte cituar fjalët e patriarkut të mëhershëm serb, Irinej, i cili kishte thënë se “varka e vogël serbe, duke lundruar në një det të trazuar, duhet të jetë gjithmonë e lidhur pas anijes së madhe ruse”. “Qëndrimi ynë për Kosovën, Republikën Sërpska [entitet në Bosnjë-Hercegovinë] dhe Malin e Zi, e konsideroj dhe e ndiej se varet edhe nga qëndrimi i Federatës Ruse në nivel global. Dëshira ime, dhe e shumicës në Kishën tonë, është që në të ardhmen, nëse ndodh një rigrupim i ri gjeopolitik, të jemi pranë atij rrethimi rus, në botën ruse”, deklaroi Porfirije.

Lidhur me deklaratat e patriarkut serb një ditë më parë kishte reaguar edhe ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, e cila tha se ato cenojnë sovranitetin e Kosovës dhe nxisin përçarje në gjithë rajonin.

Edhe nga Mali i Zi kanë reaguar për komentet e bëra nga kreu i Kishës Ortodokse Serbe gjatë takimit në Kremlin me Putinin,



duke i cilësuar “të papërshtatshme dhe të papranueshme”.

Serbia ka raporte të mira me Rusinë dhe pavarësisht presionit nga Perëndimi që të vendosë sanksione ndaj Moskës, për shkak të luftës kundër Ukrainës, Beogradi nuk e ka bërë një gjë të

tillë.

Më 2022 Parlamenti Evropian kishte shprehur shqetësim për “përpjekjet e Kishës Ortodokse në Serbi, Mal të Zi dhe në entitetin e Bosnjë-Hercegovinës, Republikën Sërpska, për ta promovuar Rusinë si mbrojtëse të vlerave tradicionale familjare

dhe për t'i forcuar lidhjet mes shtetit dhe Kishës”.

Eurodeputetët, përmes një rezolute, e kishin dënuar përpjekjen e Rusisë për t'i shfrytëzuar tensionet etnike në Ballkanin Perëndimor “për të nxitur konflikte dhe ndarje mes komuniteteve”.

FSK-ja SHPALL FITUESIT E GARËS NDËRKOMBËTARE “USHTARI MË I MIRË 2025”

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 PRILL - Në Kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj është mbyllur “Gara e ushtarit më të mirë 2025”. Aty u shpallën rezultatet e garës që është realizuar nga data 21-25.04.2025, me pjesëmarrjen e 44 konkurrenteve, 23 nga ta ishin pjesëmarrës ndërkombëtarë, ndërsa 21 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ekipet e vlerësimit të garuesve, pas përfundimit të të gjitha disiplinave, i shpallën edhe fituesit e kësaj gare ndërkombëtare.

Vendi i parë për garuesit nga FSK-ja iu dha OR2 Endrit Shatrollit nga Regjimenti i Parë i Këmbësorisë (R1K), njëherësh u shpall “Ushtari më i mirë 2025” nga FSK-ja, i dyti u radhit OR2 Arbnor Istrefi (R3K), ndërsa vendi i tretë i takoi OR3 Aurent Hodajt nga (R2K).



Në radhët e ndërkombëtarëve vendin e parë e fitoi E4 Jan Vajncer nga Republika e Kroacisë, i cili njëherësh u shpall “Ushtari më i mirë ndërkombëtar 2025”, i përcjellë nga ushtar Hil Mala nga Republika e Shqipërisë, ndërsa i vendi i tretë i takoi SSG Lucas Peterson nga Garda Kombëtare e Ajovas së ShBA-së.

Në ceremoninë përmbyllëse të garës së ushtarit më të mirë morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes në detyrë, Shemsi Sylja, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, rreshterë majorë të FSK-së dhe të vendeve partnere, si dhe oficerë

dhe nënoficerë të FSK-së, dhe të partnerëve ndërkombëtarë dhe të regionit.

Me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti Shemsi Sylja, i cili i falënderoi partnerët dhe organizatorët për realizimin e garës.

Në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, të pranishmit i falënderoi zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, i cili theksoi se kjo ngjarje është bërë tradicionale dhe mbahet që nga viti 2014, dhe është një nga qëllimet kryesore të KOMFSK-së. “Edhe kjo garë përmbush qëllimin e ndërveprimit dhe përkushtimit për të punuar dhe vepruar së bashku me partnerët”, ka pohuar ai.

Gara “Ushtari më i mirë 2025” është organizuar nga rreshterë majorët e komandave dhe njësisë të FSK-së, nën drejtimin e rreshter majorit të komandantit

të FSK-së, Bedri Zuka.

Në garën “Ushtari më i mirë 2025” morën pjesë garues nga Kosova, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëria, Kroacia, Turqia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Pjesëmarrësit garuan në disiplinat: testi fizik, gjuajtje me armë të gjata dhe të brezit, navigim tokësor, kalimi i poligonit të besueshmërisë, hedhja e granatës, ndihma e parë, vëzhgimi i terrenit dhe marshimi.

Pjesëmarrja e garuesve nga ushtritë e vendeve partnere dhe të rajonit tash e sa vite ka krijuar urat e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me FSK-në, në misionet dhe qëllime të përbashkëta, gara, ushtrime, trajnime misionet paqësore, që tregojnë qartë shkallën e lartë të bashkëpunimit me vendet partnere, që FSK e ka krijuar me punë, disiplinë, përkushtim dhe profesionalizëm.

Malajzia heq vizat për qytetarët e Kosovës

PRISHTINË, 25 PRILL - Me vendim të Qeverisë së Malajzisë, qytetarët e Republikës së Kosovës nga tani mund të udhëtojnë pa vizë në Malajzi, për një periudhë që nuk e tejkalon qëndrimin prej

tridhjetë (30) ditësh. “Republika e Kosovës mirëpret këtë hap pozitiv dhe shpreh mirënjohjen ndaj institucioneve malajziane për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme

në shërbim të qytetarëve dhe lidhjeve bilaterale gjithnjë e më të fuqishme në mes të dy vendeve tona”, ka deklaruar zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në detyrë,

Donika Gërvalla.

Ky është një tjetër hap i rëndësishëm drejt lehtësimit të lëvizjes së lirë dhe thellimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malajzisë.



Zgjerohet shërbimi për shpërndarjen e gjobave digjitale të trafikut rrugor

Prishtinë, 25 prill - Posta e Kosovës në bashkëpunim me komunën e Gjilanit dhe Policinë e Kosovës kanë zyrtarizuar zgjerimin e shërbimit për shpërndarjen e gjobave digjitale të trafikut rrugor. Marrëveshja është nënshkruar nga kryeshefja ekzekutive e Postës, Nora Rraci, kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe drejtori Rajonal i Policisë, kolonel Agron Rukiqi.

Pas implementimit të suksesshëm në kryeqytet, ky shërbim po shtrihet edhe në Gjilan, duke u mundësuar

qytetarëve pranimin e gjobave në adresat e tyre. Kjo nismë përforcon rolin e Postës së Kosovës në modernizimin e shërbimeve postare dhe në afrim të mëtejshëm me qytetarin.

Për më tepër, përmes këtij shërbimi Posta e Kosovës po kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e sigurisë në trafik, duke mbështetur zbatimin më të qëndrueshëm dhe efektiv të masave ndëshkuese dhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për respektimin e rregullave rrugore.

Posta e Kosovës falënderon komunën e Gjilanit dhe Policinë e Kosovës për bashkëpunimin e frytshëm. Zgjerimi i këtij shërbimi do të vazhdojë edhe në komuna të tjera, në funksion të modernizimit dhe rritjes së qasjes në shërbime publike. Posta e Kosovës synon të ndërtojë një rrjet shërbimesh të integruara, të besueshme dhe digjitale, duke qenë një partner strategjik për institucionet, një mbështetje për bizneset dhe një shërbim i afërt me çdo qytetar, anëmbanë Republikës së Kosovës.



DEFICIT TREGTAR PREJ 21,8 % NË MUAJIN MARS KRAHASUAR ME MARSIN E VITIT TË KALUAR

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin mars 2025. Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 21,8 % në muajin mars 2025 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej 535,7 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 439,7 milionë eurosh në vitin 2024. Eksporti mbulon importin me 12,2 %.

Eksporti i mallrave në muajin mars 2025 kishte vlerën 74,7 milionë euro, ndërsa importi 610,5 milionë euro, që është një rënie prej (-7,2 %) për eksport, si dhe një rritje prej 17,3 % për import, krahasuar

me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 23,6 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11,9 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 11,8 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura; 10,7 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; pijet dhe duhani; 9 % e përbëjnë produktet minerale etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 15,9 % e përbëjnë produktet minerale; 12,8 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10,7 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,3 % e përbëjnë mjetet e transportit; 9 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, etj.



Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 25,9 milionë euro, ose rreth 34,8 % e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-15,8 %). Partnerët kryesorë për

eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (10,8 %), Holanda (3,3 %), Italia (3,3 %) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 249 milionë euro, ose 40,8 % e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-1,1 %). Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (12,6 %), Italia (5,5 %), Polonia (3,2 %) etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 33,5 milionë euro ose 44,8 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 3,3 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (15,8 %), Shqipëria (14,7 %), Mali i Zi (6,6 %), Serbia (5,9 %). Importet nga

vendet e CEFTA-s arritën në 101,5 milionë euro, ose 16,6 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 51,1 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (6,5 %), Shqipëria (5,1 %), Serbia (3,7 %).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,3 milionë euro, ose 20,5 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (10,1 %) dhe ShBA-ja (3 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 259,9 milionë euro, ose 42,6 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14 %) dhe Kina (12 %).

ZËVENDËSAUDITORI I PËRGJITHSHËM MORI PJESË NË KONFERENCËN “FUQIZIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË”



PRISHTINË, 25 PRILL - Në kuadër të bashkëpunimit ndërins-titucional, të enjten është mbajtur konferenca “Fuqizimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë”, organizuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në bashkëpunim me SIGMA/OECD. Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve kyçe që

mbikëqyrin prokurimin publik si dhe pati për synim rritjen e bashkëpunimit dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik. Zëvendësauditori i përgjithshëm, Bezad Halilaj, foli për rolin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të prokurimit publik. Ai theksoi rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të

auditimit si dhe nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve. Halilaj tregoi se shumica e gjetjeve që ZKA-ja evidenton në raportet e auditimit i përkasin fushës së prokurimit publik dhe kjo tregon se ende ka mangësi në të gjitha fazat e procesit. Ai tha se ZKA-ja mbetet e përkushtuar për ta dhënë kontributin për ta forcuar

sistemin e prokurimit publik dhe për të siguruar zbatim më efektiv të ligjit. Në kuadër të punimeve të konferencës u diskutuan praktikatat e mira dhe sfidat në këtë fushë, përfshirë përvojën e Komitetit Ndër-Ministror të Prokurimit Publik në Rumani si dhe përmirësimin e cilësisë dhe transparencës në raportimet vjetore.

KEK-u thotë se ka përfunduar me sukses remonti i Njesisë B1

PRISHTINË, 25 PRILL - Korporata Energjetike e Kosovës njofton se kanë përfunduar me sukses të gjitha punimet e planifikuara për remontin e njesisë B1, të cilat kishin nisur më 23.03.2025 dhe kanë përfunduar përpara

afatit të parashikuar. Në njoftim thuhet se gjatë kësaj periudhe janë realizuar riparime dhe përmirësime të ndryshme, duke përfshirë ndërrimin e pjesëve të dëmtuara, rinovimin e sistemeve të ndryshme dhe realizimin e

procedurave të domos-doshme për stabilitetin dhe efikasitetin e njesisë. “Falë përgatitjes dhe kontrollit të kujdesshëm, si dhe angazhimit të palodhshëm të ekipit të ekspertëve të TC-B-së, njësia B1 është sinkronizuar me rrjetin

elektrik në orën 22:32 të datës 24.04.2025 dhe aktualisht gjendja e saj është stabile. Kjo arritje është një dëshmi e punës së shkëlqyer të të gjithë të përfshirëve dhe vlerësimit të lartë të performancës gjatë periudhës së remontit”, thuhet në njoftim.



CHATGPT PARASHIKON SE KUSH DO TË JETË PAPA I RI MES 135 KANDIDATËVE



Inteligjenca Artificiale ka parashikuar se kush do të jetë pasardhësi i Papa Françeskut nga 135 kandidatët e mundshëm.

Duke analizuar karakteristikat specifike, kualifikimet dhe rrugët e karrierës së çdo kandidati, teknologjia sipas mediave të huaja identifikoi atë që konsiderohet personi më i mundshëm për të marrë drejtimin e Kishës Katolike Romake.

Ndërsa të gjithë sytë mbeten te oxhaku i Kapelës Sistine, në pritje të tymit të bardhë që do të sinjalizojë zgjedhjen e Papës së re, ChatGPT, mjeti kryesor i inteligjencës artificiale të OpenAI, ka përcaktuar se kardinali Pietro Parolin do zgjidhet si pasardhësi i Papa Françeskut.

Sekretar i Shtetit të Vatikanit për më shumë se 10 vjet, Parolin, nëse zgjidhet, do t'i "rikthejë" titullin e Papës

Italisë pas 40 vitesh, pasi tre liderët e mëparshëm nuk ishin italianë.

Pse ChatGPT zgjedh Parolin? Ai konsiderohet si pasardhës "ideal" i Papa Françeskut, sepse pranohet si nga reformatoret, ashtu edhe nga tradicionalistët.

Në fletëvotimet e mbyllura, ku kardinalët evropianë dhe të Amerikës Latine luajnë një rol vendimtar, ai konsiderohet një zgjedhje e sigurt nëse një

kandidat qartësisht progresiv nuk mund të mbizotërojë.

Ndër avantazhet që shoqërojnë Parolin, ChatGPT merr parasysh përvojën e tij të gjatë diplomatike, aftësinë e tij për të folur shumë gjuhë. Megjithatë, nuk përmendet përfshirja e tij në një skandal financiar të Vatikanit, që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme në Londër dhe që mund të funksionojë kundër zgjedhjes së tij.

Në çdo rast, ChatGPT e konsideron Parolin si "të preferuarin" edhe pse ka bashkëkandidatë të rëndësishëm. Edhe pse ky person do të ishte zgjedhja "më e sigurt" për të vazhduar punën e Papa Françeskut, gjithashtu pretendentë të fortë për të marrë drejtimin e Kishës Katolike Romake janë kryesisht Luis Antonio Gokim Tagle, Fridolin Ambongo Besungu dhe Mateo Chupí.

"Ukraina, jo pjesë e NATO", Trump: Krimea do të mbetet e Rusisë

Gadishulli i Krimesë është tashmë pjesë e Rusisë dhe ashtu do të jetë. Kështë është shprehur Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump.

Në një intervistë për prestigjiozen "Times", Trump theksoi se Zelensky e kupton shumë mirë se Krimea do të qëndrojë me Rusinë. Trump fajësoi paraardhësin e tij për këtë dështim.

"Më pyet nëse Kriema do të

qëndrojë me Rusinë, ne po flasim për të pasi vetëm ajo po përmendet këto ditë. Kriema do të qëndrojë me Rusinë. Zelenski e kupton mjaft mirë këtë gjë dhe të gjithë e kuptojnë madje sepse gadishulli ka qenë me rusët për një kohë shumë të gjatë.

Kjo ka ndodhur shumë herët para se të vinte Trump në detyrë. E përsëris se kjo ishte lufta e Obamës. Kjo ishte një luftë që nuk do të kishte

ndodhur kurrë", tha Trump.


Trump është shprehur kundër edhe idesë për anëtarësimin e Ukrainës në NATO. Madje anëtarësimi në NATO shikohet edhe si një nga shkaktarët e fillimit të luftës në vitin 2022.

"Unë nuk mendoj se Ukraina do të anëtarësohet ndonjëherë në NATO. Mendoj se kjo ka qenë e ditur që nga dita e parë, kjo është arsyeja, besoj, e fillimit të luftës. Nëse kjo çështje nuk do të ishte trajtuar që në fillim,

do të kishim një shans më të mirë për rajonin", shtoi ai.

Trump bëri edhe një "Mea Kulpa" kur tha se përfundimi i luftës në 24 orë është e ekzagjeruar. Ai pranoi se kjo frazë është thënë për një përfundim sa më të shpejtë të luftës. Në fund Trump gjeti kohë të lavdëronte edhe "të preferuarin e tij", Vladimir Putin, për të cilën tha se ai është i vetmi president që mund ti japë fund luftës.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kualifikimi në Botëror, KOK-u shpërblen Kosovën U18

Komiteti Olimpik i Kosovës ka shpërblyer me 6 000 euro Përfaqësuesen e Kosovës në Hendboll për grupmshën U18

për kualifikimin në Kampionatin Botëror U-19, që këtë vit mbahet në Kajro të Egjiptit. Vendimi u mor nga

Bordi Ekzekutiv i KOK-ut në mbledhjen e mbajtur mbrëmë. “Djemtë e U18 fituan turneun ‘IHF Trophy Intercontinental’, të

mbajtur në Prishtinë, duke siguruar biletën për Botëror. Me shumën e njëjtë, KOK-u kishte shpërblyer vitin e kaluar edhe

Përfaqësuesen e vajzave U-17, të cilat po ashtu ishin kualifikuar në Botërorin e mbajtur në Kinë”, thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Sonte gjysmëfinalja e tretë në mes të Trepçës dhe Prishtinës

MITROVICË, 25 PRILL - “Play-off”-i i ProCredit Superligës po vazhdon me spektakël. Ndeshjet çerekfinale dhe gjysmëfinale dhuruan spektakël të basketbollit, derisa palestrat janë të mbushura për t’i hijeshuar edhe më shumë garat shtesë të elitës së basketbollit. Dramë dhe adrenalinë kishte në sfidat gjysmëfinale, ku seria është 1:1, derisa në fundjavë zhvillohen ndeshjet e treta. Palestra “Minatori” sërisht do të jetë arenë e një superderbi, ku ndeshen Trepça dhe Sigal Prishtina. “Xehetarët” fituan ndeshjen e parë 80:65, kurse “bardhekaltrit” ndeshjen e dytë 90:83 pas vazhdimëve. Të dyja skuadrat hyjnë për fitore dhe për të bërë një hap drejt finales. Në Prizren zhvillohet dueli tjetër ndërmjet Bashkimit dhe Pejës, ku sfida është shumë e rëndësishme për të dyja skuadrat. Takimi i parë përfundoi me fitoren e prizrenasve 81:61, kurse i dyti me fitoren e pejanëve 84:79. Skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finale, derisa për t’u shpallur kampione nga ky edicion është me katër fitore.



Çeku: Brenda këtij viti përfundojnë punimet në stadiumin ‘Adem Jashari’

Mitrovicë, 25 prill - Ministri në detyrë i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se punët në stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë po vazhdojnë me dinamikë të lartë dhe se këto punime do të përfundojnë brenda vitit. “Punimet në stadiumin ‘Adem Jashari’ në Mitrovicë po vazhdojnë me dinamikë të lartë. Brenda këtij viti punët pritet të përfundojnë, duke i dhënë qytetit një stadium të ri, modern dhe njëherësh më të madhin në vend – në shërbim të klubeve, sportistëve dhe tifozëve mitrovicas”, ka thënë Çeku. “Vazhdojmë pa u ndalur me konsolidimin e infrastrukturës së sportit në gjithë vendin. Po punohet edhe në stadiumet e Shtimes, Gjakovës dhe Hogoshtit të Kamenicës, si dhe pesë stadione ndihmëse, ndërsa pritet të nisin punimet edhe në Gjiilan, Prizren, Pejë, Ferizaj, Vushtrri dhe Suharekë. Me këtë përkushtim e seriozitet, nuk është investuar asnjëherë në infrastrukturën e futbollit në vend”, ka shtuar Çeku.



Arteta: Ta kthejmë në festë ndeshjen ndaj PSG-së

Pas barazimit kundër Crystal Palaces, trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, foli edhe për përballjen e së

martës me PSG-në në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve. “Le të luajmë të martën mbrëma të gjithë

së bashku këtu për të përjetuar një nga netët më të pabesueshme në Ligën e Kampionëve. Ndeshja ndaj

Palace? Jam shumë i zhgënjyer me rezultatin dhe gjithashtu me disa aspekte të performancës. Ishte një

ndeshje e vështirë dhe merita i takon kundërshtarit”, ka thënë Arteta.

SHKURT

U hodh shorti për gjysmëfinalen e Kupës së Kosovës për Femra

Në praninë e përfaqësuesve të klubeve të premtën është bërë tërheqja e shortit për gjysmëfinalen e Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave. Dy skuadrat lidere të Superligës, Dukagjini dhe Mitrovica, iu shmangën përballjes në këtë fazë. Dukagjini në short tërhoqi për kundërshtar skuadrën kryesuese të Ligës së Parë, Prishtinën, derisa Mitrovica do të ballafaqohet me Malishevën. Ndeshjet e para zhvillohen më 7 maj në Klinë dhe Malishevë, ndërsa ato të kthimit në Prishtinë e Mitrovicë më 14 maj.

Çdo gjë gati për Final 4 të Kupës, premtohet spektakël

Të premtën në Federatën e Hendbollit të Kosovës është mbajtur konferencë për shtyp lidhur me Final 4 të Kupës së Kosovës në Hendboll. Në konferencë folën presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Edin Kolgeci, dhe kryetari i KH Kastriotit, Fisnik Jashari. Kolgeci ka treguar se çdo gjë është gati për turneun final të Kupës, që të shtunën (nesër) e të dielën mbahet në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj. Duke u dëshiruar tetë skuadrave pjesëmarrëse suksese, Kolgeci është shprehur i bindur se Final 4 i Kupës do të jetë spektakël hendbolli. Jashari, si udhëheqës i njërës prej klubeve nikoqire, ka treguar për punët që kanë përfunduar deri më tani. Ai ka treguar se në kuadër të turneut final do të ketë edhe program artistik, ndërsa u ka bërë thirrje të gjithë adhuruesve të hendbollit që të shtunën e të dielën të jenë në palestrën në Ferizaj.

Fitorja e parë me Anderlechtin, Hasi: Ky është vetëm fillimi

ANDERLECHT, 25 PRILL - Besnik Hasi arriti ta sigurojë fitoren e parë në stolin e klubit belg, Anderlecht, duke udhëhequr skuadrën drejt një fitoreje të thellë 5-0 kundër Gentit, një rezultat që ka entuziazmuar tifozët dhe ka dhënë menjëherë sinjale të forta

për sezonin që pritet. Nën drejtimin e Hasit, Anderlechtit tregoi një lojë të balancuar, të shpejtë dhe agresive në të gjitha repartet. Dominimi ishte i dukshëm që në minutat e para të takimit, ndërsa organizimi i saktë në fushë reflektoi qartë

dorën e trajnerit të ri. Ajo që ra në sy ishte energjia dhe mentaliteti i lojtarëve, të cilët dukshëm ishin të motivuar për ta bindur Hasin. Pas ndeshjes, trajneri shqiptar u shpreh i kënaqur me paraqitjen e skuadrës dhe theksoi se ky ishte vetëm një

hap i parë. “Jam shumë i lumtur për fitoren dhe mënyrën si luajtëm, por ky është vetëm fillimi. Ka ende shumë punë përpara dhe duhet të jemi të përlurur”, u shpreh Hasi. Për Hasin ky është një rikthim në një ambient të njohur, pasi në të



kaluarën ka qenë pjesë e Anderlechtit si lojtar dhe më pas si pjesë e stafit teknik.

FC Prishtina 01 triumfon në finalen dramatike të Kupës së Kosovës në Futsall

PRISHTINË, 25 PRILL - Finalja e Kupës së Kosovës në Futsall dhuroi spektakël të vërtetë në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në kryeqytet, ku FC Prishtina 01 doli fituese ndaj FC Vjosa me rezultat 5:4 pas vazhdimëve. Në një atmosferë elektrizuese në një palestër pothuajse të stërmbushur me tifozë, të dyja skuadrat ofruan një prej ndeshjeve më emocionuese të këtij edicioni. Pjesa e parë përfundoi barazim, 2:2. Për Prishtinën 01 dy herë realizoi Drilon Maxharraj, ndërsa për Vjosën shënuan Jetmir Gashi dhe Jesus Rivas. Në pjesën e dytë Halim Selmanaj dhe Ramadan Alaj i dhanë epërsinë Prishtinës me rezultat 4:2, por Vjosa reagoi fuqishëm. Fillimisht, Jesus Vidal ngushtoi rezultatin në 4:3, ndërsa në sekondat e fundit një autogol i Melos Kelmendit barazoi gjithçka në 4:4, duke çuar ndeshjen në vazhdimë. Në vazhdimë dy herë nga 5 minuta, Fitim Krasniqi shënoi golin vendimtar për 5:4, duke i siguruar FC Prishtina 01 trofeun e çmuar të Kupës së



Kosovës në futsall. Ky është trofeu i katërt për këtë skuadër në këtë garë dhe i treti radhazi. Spektakli i mbrëmjes u zbeh kur kishin mbetur 25 sekonda deri në fund të vazhdimëve, kur skuadra e Vjosës refuzoi ta vazhdojë lojën në shenjë pakënaqësie ndaj një vendimi të gjyqtarëve. Kjo shkaktoi reagime edhe nga tifozët e shumtë të Vjosës, të cilët hodhën gjësende në parket. Gjyqtarët pritën për pesë minuta rikthimin e ekipit në fushë, por kjo nuk ndodhi, dhe më pas

dhanë shenjë për përfundimin e ndeshjes. Në fund, medaljet dhe trofeun për ekipin fitues i dhanë anëtarë i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Ismajl Ajeti, kryetari i Komisionit të Futsallit, Hysni Gjinovci, si dhe drejtori i Sportit në komunën e Prishtinës, Kushtrim Mushica. Përveç momenteve të fundit të pakëndshme, kjo finale dëshmoi nivelin në rritje të futsallit të Kosovës dhe pasionin gjithnjë në rritje të publikut për këtë sport dinamik.

Benjamin Imeri, gati për ndeshjen më të madhe në WBO

GOSTIVAR, 25 PRILL - Fjala është për 21-vjeçarin Benjamin Imeri, i cili ka lindur në Gostivar të Maqedonisë. Që në moshën 16-vjeçare nisi debutimin në sportet luftarakë, ku në verën e vitit 2022 u përballë kundër kampionit evropian në kikkoks. Ai ka zhvilluar nëntë ndeshje në boks profesionist ku ka pasur vetëm fitore. Imeri ka zgjedhur të jetojë dhe njëkohësisht të përgatitet në Berlin të Gjermanisë, ndërsa vetëm pak ditë më parë ai mori vesh se ka fituar të drejtën të sfidohet me titullin WBO, federatë kjo më prestigjioze në botën e boksit, ku do të jetë për titullin Youth, apo thënë ndryshe për të parin e



botës deri në moshën 25-vjeçare. Benjamin Imeri është kushëri i një prej personazheve të njohur të showbizit evropian, konkretisht Sado Maksuti. Falë punës dhe përkushtimit të tij ai deri këtu ka arritur duke pasur

ndeshje të forta kundër emrave si Siarhei Huliakevich nga Bjellorusia i cili ka qenë kampion Evrope dhe numër një në WBC, të cilin Benjamini ynë e ka mposhtur në raundin e 3-të. Ai po bëhet gati për sfidën më të madhe dhe më të rëndësishme pasi do të sfidohet për titullin kampion bote në shtetin ku ky sport ka arritur majat siç është Anglia, pra në Londër, më 28 qershor e deri tash i janë propozuar tre emra të fortë ku njëri do të jetë përballë shqiptarit. Imeri ka pasur deri tash vetëm fitore. Urojmë dhe besojmë se edhe kjo ndeshje do të jetë fitorja më e madhe për të e ku do të na bëjë krenarë të gjithëve, sidomos ne shqiptarëve.

SHKURT

Kosova shënon për herë të parë Ditën Ndërkombëtare të Paravolejbollit

Në një atmosferë të veçantë dhe përplot emocion, u shënua për herë të parë në Kosovë Dita Ndërkombëtare e Paravolejbollit – një hap domethënës drejt përfshirjes, barazisë dhe zhvillimit të sportit për persona me aftësi të kufizuara. Ngjarja mbledhi bashkë figura të rëndësishme nga sporti dhe institucionet vendore, ndërsa u zhvillua edhe një ndeshje miqësore mes KPV “Lipjani” dhe KPV “Prishtina”, duke treguar talentin dhe përkushtimin e sportistëve tanë. Federata e Volejbollit e Kosovës përgëzon Federatën e Paravolejbollit të Kosovës për organizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm, ku sporti i rrjetës bëhet urë mundësish për secilin pjesëtar të shoqërisë sonë. Në emër të FVK-së, këtë aktivitet e përshëndeti Valon Nikqi, sekretar i përgjithshëm i Federatës së Volejbollit të Kosovës.

Norris: Po gaboj shumë të shtunave, në garë po argëtohem

Duke përjashtuar fitoren e Max Verstappenit në Çmimin e Madh të Japonisë, katër nga pesë garat e para të këtij botërori të Formulës 1 kanë parë një pilot të McLarenit të qëndrojnë në shkallën e parë të podiumit. Në tri raste (Kinë, Bahrein dhe Arabi Saudite) ka fituar lideri aktual i botërorit, Oscar Piastri. Ndërkohë që, kampionati u hap me fitoren e Lando Norris (Australi). Britaniku tani ka 10 pikë disavantazh ndaj shokut të tij të skuadrës. “Mendoj se jam mjaft i kënaqur me garat e mia. Ato kanë qenë mjaft pozitive. Në të gjitha garat ritmi ka qenë i mirë dhe ndihem më i miri për momentin, por të shtunave e bëj jetën time shumë të vështirë”, ka thënë Lando Norris. “Po përpiqem shumë. Ndonjë jo e mirë në provat zyrtare i bënë të dielat e mia pak më argëtuese. Duhet të punoj të shtunave, dhe nëse mund ta bëj këtë, jam i bindur se mund të kthehem aty ku kam filluar”, ka thënë Norrisi.

Mourinho kujton humbjen ndaj Barcelonës: Ishte humbja më e mirë në karrierë

Interi dhe Barcelona do të përballen në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, ku rikthehen në fazën e njëjtë në të cilën ishin para 15 viteve. Atëbotë Interi kishte avancuar tutje, pas fitores 3:1 në ndeshjen e parë dhe humbjes 1:0 në përballjen e kthimit. E lidhur me ndeshjen e kthimit, ka folur trajneri i atëhershëm i Interit, Jose Mourinho. Trajneri portugez e cilësoi atë si humbjen më të mirë në karrierë. “Mendoj se isha i shkëlqyer në mënyrën se si organizova ekipin. Ne u mbrojtëm me të gjitha forcat, me zemër, me shpirt. Kjo është humbja më e mirë në karrierën time. Ne dhamë gjithçka, humbëm 1-0, por arritëm në finale”, u shpreh Mourinho.

De Bruyne largohet në maj, refuzon të luajë me Cityn në Kupën e Botës për klube

Kevin De Bruyne nuk do ta zgjasë kontratën e tij me Manchester City për të luajtur në Kupën e Botës për klube këtë verë. Lajmin e konfirmoi “The Mirror”.

Mesfushori do të largohet nga City në fund të majit, menjëherë pasi të luajë edhe ndeshjen e fundit sezonale, atë ndaj Fulhamit më 25 maj. Ndërkohë që sfida e fundit

para fansave të tij do të jetë ndaj Bournemouthit. Kontrata e De Bruyne është e vlefshme deri në fund të qershorit, që është në mes të Kupës së Botës për klube, turne që zhvillohet

në Majemi. Lojtarët kanë mundësinë ta zgjasin kontratën edhe dy javë të tjera për t’ua dhënë atyre mundësinë të luajnë në turneun e zgjeruar të FIFA-s.

Gjithsesi, belgu ka vendosur të largohet më herët. De Bruyne mbeti i zhgënjyer që klubi nuk i ofroi një kontratë të re. Pritet që ai të luajë në MLS sezonin tjetër.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “IKS-RECYCLING PROGRAM” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811167833 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "IKS-RECYCLING PROGRAM" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811167833 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “IKS-RECYCLING PROGRAM” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811167833 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hashim Bahtiri shpall të pavlefshme diplomën e SHMLE "Hasan Prishtina".
- Ferdije Ibishi shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit-Shkolla e lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" Prizren.
- Ilir Hajredin shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- N.P.SH. MONT-EL shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 70171795.
- Besnik Tahiri B.I. Shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810564957.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për informund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohu ni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Mendon për ty!

Bilanci i gjendjes me: 31/03/2025	Euro '000	
	Tremujori paraprak 31/12/2024	Tremujori vijues 31/03/2025
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	78,309	59,145
Kërkesat ndaj bankave	22,407	23,012
Bonot e thesarit	0	0
Investimet në letra me vlerë	55,749	60,498
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	491,220	497,536
Patundshmëritë dhe pajisjet	14,271	13,670
Pasuritë e paprekshme	2,470	2,532
Pasuritë tatimore të shtyra	0	0
Pasuritë tjera	10,855	9,804
Gjithsej pasuritë	675,281	666,196
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	596,936	583,768
Detyrimet ndaj bankave	1,096	2,503
Fondet tjera të huazuara	0	0
Detyrimet tatimore të shtyra	0	0
Detyrimet tjera	4,527	4,315
Gjithsej detyrimet	602,559	590,586
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	29,422	29,422
Rezervat e kapitalit	4,774	4,854
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	27,833	38,529
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	10,694	2,805
Përbërësit tjerë të ekuitetit	0	0
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	72,722	75,610
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	675,281	666,196

www.bekonomike.com | info@bekonomike.com
+383 (0) 38 500 500 | +383 (0) 49 73 33 22

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31/03/2025	Euro '000	
	Tremujori paraprak 31/12/2024	Tremujori vijues 31/03/2025
Të hyrat nga interesi	35,971	9,488
Shpenzimet e interesit	(7,678)	(1,910)
Neto të hyrat nga interesi	28,293	7,578
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	6,293	1,584
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	(1,812)	(905)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	4,480	679
Neto të hyrat nga tregtimi	155	35
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	375	24
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	(18,995)	(4,464)
Gjithsej të hyrat	14,308	3,852
Provizionet për humbjet nga kreditë	(2,652)	(735)
Fitimi/(humbja) para tatimit	11,657	3,117
Shpenzimet e tatimit në fitim	(963)	(312)
Fitimi/(humbja) neto	10,694	2,805
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	21	60
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	10,714	2,865



Mendon për ty!

Bilanci i gjendjes me: 31/12/2024	Euro '000	
	Tremujori paraprak 30/09/2024	Tremujori vijues 31/12/2024
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	57,024	78,309
Kërkesat ndaj bankave	27,488	22,407
Bonot e thesarit	0	0
Investimet në letra me vlerë	62,093	55,749
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	484,317	491,220
Patundshmëritë dhe pajisjet	14,514	14,271
Pasuritë e paprekshme	2,018	2,470
Pasuritë tatimore të shtyra	0	0
Pasuritë tjera	11,644	10,855
Gjithsej pasuritë	659,097	675,281
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	538,904	596,936
Detyrimet ndaj bankave	582	1,096
Fondet tjera të huazuara	0	0
Detyrimet tatimore të shtyra	0	0
Detyrimet tjera	4,476	4,527
Gjithsej detyrimet	588,962	602,559
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	29,422	29,422
Rezervat e kapitalit	4,653	4,774
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	27,833	27,833
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	8,227	10,694
Përbërësit tjerë të ekuitetit	0	0
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	70,135	72,722
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	659,097	675,281

www.bekonomike.com | info@bekonomike.com
+383 (0) 38 500 500 | +383 (0) 49 73 33 22

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31/12/2024	Euro '000	
	Tremujori paraprak 30/09/2024	Tremujori vijues 31/12/2024
Të hyrat nga interesi	26,578	35,971
Shpenzimet e interesit	(5,600)	(7,678)
Neto të hyrat nga interesi	20,979	28,293
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	4,690	6,293
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	(1,361)	(1,812)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	3,329	4,480
Neto të hyrat nga tregtimi	135	155
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	356	375
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	(13,178)	(18,995)
Gjithsej të hyrat	11,620	14,308
Provizionet për humbjet nga kreditë	(2,480)	(2,652)
Fitimi/(humbja) para tatimit	9,141	11,657
Shpenzimet e tatimit në fitim	(914)	(963)
Fitimi/(humbja) neto	8,227	10,694
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	(117)	21
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	8,110	10,714

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L